



MINISTRJA EKONOMI MBLEDH PËRFAQËSUESIT E INSTITUCIONEVE SHTETËRORE NË KUADËR TË INICIATIVËS SË PARTNERITETIT TË QEVERISJES SË HAPUR (OGP)

Ministrja e Shtetit për Standardet e Shërbimeve Milva Ekonomi zhvilloi një takim online me pikat e kontaktit të përcaktuara nga ministritë e linjës për komunikimin me shoqërinë civile në kuadër të iniciativës së Partneritetit të Qeverisjes së Hapur OGP. Në fokus ishte metodologjia e re e OGP-së në kuadër të procesit të bashkë-krijimit të Planit të Ri të Veprimit 2022-2024, duke vënë theksin te konsultimi me të gjithë aktorët e shoqërisë civile dhe publikun e gjerë, si dhe marrja e ideve dhe propozimeve të tyre në hartimin e angazhimeve për tu përfshirë në planin e ri të

BRUKSEL: TAKIMI SHPJEGUES ME BE-NË MBI REFORMËN NË ADMINISTRATËN PUBLIKE

U zhvillua në Bruksel takimi i fundit për këtë vit (bilateral screening) mbi Reformën në Administratën Publike. Ministrja e Shtetit për Standardet e Shërbimeve Milva Ekonomi e pranishme online në këtë takim, ndau me përfaqësuesit e BE-së zhvillimet e këtyre reformave të cilat kanë në fokus nevojat e qytetarëve dhe bizneseve, të cilëve duhet t'u shërbehet me cilësi, nga një administratë publike e aftë që punon me efikasitet dhe integritet të lartë dhe ku objektivi është rritja e vazhdueshme e cilësisë së menaxhimit, llogaridhënia dhe transparencja. Në fund të fjalës së saj Ministrja Ekonomi falenderoi edhe ekipin tonë për prezantimin dinjitoz dhe të suksesshëm.



TË BASHKUAR PËR T'I DHËNË FUND DHUNËS NDAJ GRAVE

Ministrja Ekonomi ishte e ftuar në ceremoninë e zbulimit të murales për rritjen e ndërgjegjësimit kundër dhunës ndaj grave në Durrës. Bashkë me Ministren e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Ogerta Manastirliu, Alban Xhelili, Ilirjana Basha, Elsa Håstad ambasadore e Suedisë në vendin tonë dhe partnerët e Kombeve të Bashkuara, Michele Ribotta nga UNWomen në kuadër të fushatës së 16 ditëve të aktivizmit kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës me bazë gjinore.

QEVERISJA ELEKTRONIKE NË RAJON PARË NGA KËNDVËSHTRIMI I PARTNERITETIT TË QEVERISJES SË HAPUR

Përfaqësues nga Ministri i Shtetit për Standardet e Shërbimeve morën pjesë në workshopin rajonal të organizuar nga Open Data Kosova me temë "Qeverisja elektronike në rajon parë nga këndvështrimi i Partneritetit të Qeverisjes së Hapur dhe iniciativave të tjera", ku u nda me të pranishmit shembulli se si vendi ynë po vepron në kuadër të iniciativës së Partneritetit të Qeverisjes së Hapur dhe hapave të ndërmarra deri tani për të përmbushur kriteret e kërkuara nga kjo iniciativë në raport me shoqërinë civile si transparencja, llogaridhënia por sidomos gjithëpërfshirja në hartimin e politikave.



FESTAT DUAN DASHURI

Ministrja Ekonomi iu bashkua nismës për të uruar dhe për të ndarë gëzimin e festave me familjet në Sukth (Durrës), të cilët mbështeten me ndihmë ekonomike.

Prej 1 janarit 2023 nuk do të jenë të pakta edhe ato familje që do të përfitojnë gjithashtu nga politika e re e mbështetjes së qeverisë për nënat e papuna me tre ose më shumë fëmijë nën 18-vjeç.

MBRËMJJA FESTIVE NGA CONFINDUSTRIA ALBANIA

Ministrja e Shtetit për Standardet e Shërbimeve Milva Ekonomi ishte e ftuar në mbrëmjen festive të organizuar nga Confindustria Albania, për të bërë një bilanc të vitit që po mbyllet. Të dhënat tregojnë që bashkëpunimi i kompanive shqiptare dhe italiane tashmë është i konsoliduar e pavarësisht sfidave që po kalohet mes luftës në Ukrainë dhe rrezikut të Inflacionit, ato ja kanë dalë të performojnë me rezultate pozitive. Me urimin që viti 2023 të jetë edhe më i suksesshëm, Ministrja Ekonomi i falenderoi miqtë e Confindustria Albania për kontributin e tyre në zhvillimin e marrëdhënieve ekonomike mes dy vendeve tona.

